

V E N D I M
Nr. 18, datë 28.1.2002

**PËR TRAJTIMIN E PUNONJËSVE QË DALIN TË PAPUNË NGA PROCESI I
RISTRUKTURIMIT TË ALBTRANSPORT SH.A.-SË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë” dhe të nenit 58 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1995 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Punonjësit që mbeten të papunë nga procesi i ristrukturimit të Albtransport sh.a., nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi deri në çastin e dhënies me koncesion të shoqërisë, të trajtohen financiarisht për një periudhë dyvjeçare në masën 100 për qind të pagës bazë mujore, të shtesës së vjetërsisë në punë dhe për sigurimet e detyrueshme, në çastin e shkëputjes nga puna.

2. Kjo periudhë e pagesës për këta punonjës të njihet si vjetërsi në punë për efekt pensioni dhe të shënohet e tillë në librezën e punës.

3. Të drejtën e trajtimit sipas këtij vendimi e kanë ata punonjës që kanë qenë të punësuar në këtë shoqëri deri në çastin e kalimit të saj në konservim, pa ndërprerje, për një periudhë kohe jo më pak se 1 vit, e që nuk zhvillojnë veprimtari ekonomike në formën e punësimit apo vetëpunësimit. Në rast të kundërt, u ndërpritet trajtimi që përfitojnë sipas këtij vendimi.

4. Fondet financiare të nevojshme për kryerjen e pagesës për periudhën dyvjeçare dhe për sigurimet e detyrueshme të përballohen nga Albtransport sh.a. Pagesat e punonjësve të bëhen nga zyrat e punësimit në rrethet përkatëse, duke bërë kalimin e fondeve të mësipërme në Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale.

5. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Ministria e Transportit dhe Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale për nxjerrjen e udhëzimit përkatës dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta